



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **48**

Prishtinë, më 10.6.2009, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Myrvete Pantina, Elheme Hetemi, Haset Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi.

Munguan : Zulfë Merxha, Zef Morina, Dragiša Mirić, Ali Lajçi, Lulzim Zeneli.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Të ftuar nuk ka pasur, vëzhgues ishin nga OSCE Blerim Vela dhe Maria Berishaj dhe vëzhgues tjerë.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Mustafë Nuhiu.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë për Drejtor e zv. Drejtor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina,
3. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryesuesi konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2. Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë për Drejtor e zv. Drejtor të Rregullatorit për Ujëra e Mbeturina

Naim Maloku sqaroi për obligimin e komisionit që konsiston në rekomandimin sa i përket kandidatëve të rekomanduar nga Qeveria lidhur me drejtorin dhe zv. drejtorin në ZRRUM, ndaj e hapi diskutimin.

Berat Luzha tha se ZRRUM me drejtorin aktual ka njoftuar këtë komision me raportin e punës i cili është vlerësuar mjaft mirë si në komision ashtu edhe në seancën plenare, mirëpo

tani komisioni duhet të rekomandoi rreth vendimit të Qeverisë për dy kandidatët e rekomanduar.

Selvie Halimi gjithashtu tha se duhet të përkrahen dy kandidatët por ky rekomandim do të duhej të rekomandon edhe ndryshim-plotësimin e ligjit përkatës për procedurën e emërimit të këtyre personave në institucionet e pavarura, dmth të hartohet ligji i veçantë që saktëson procedurën e rregullt ligjore, pasi që nuk ka rregullativë për këtë çështje. Nëse varet nga Kuvendi, atëherë duhet të ketë mundësi të diskutohet me kandidatët e propozuar.

Heset Cakolli ishte në dilemë ngase nuk ka procedurë dhe qartësi se si emërohen këta kandidat, ndaj ishte i mendimit se zyra ligjore e Kuvendit duhet të deklarohet se është ligjore apo jo kjo mënyrë e procedimit për kandidatë të potencuar, përndryshe nëse Qeveria i ka emëruar dhe rekomanduar kandidatët, përse ky komision të jap mendimin, pyeti ai.

Myrvete Pantina tha se nuk dëshiron ndonjë zhargitje nga komisioni por është e paqartë se si Qeveria i ka përzgjedhë këta kandidatë, ndaj për hera tjera duhet të sqarohen mundësitë për këto procedura. U pajtua të jap mendimin zyra ligjore e Kuvendit.

Blerim Vela sugjeroi të jap mendimin ZRRUM rreth procedurave të zgjedhjes së eprorëve në këtë zyre, ngase ata duhet të përgatiten poashtu rreth punës së mëtejme në këtë zyre.

Elhëme Hetemi ishte e mendimit se janë dhënë bazat ligjore ngase kandidatit aktual i ka kaluar mandati, secili anëtarë ka pasur kohë të analizoi, ajo nuk kundërshtoi se komisioni duhet të ketë qasje për ti vlerësuar kandidatët për të fituar një pasqyrë për ata (propozimi i Selvie Halimit) por nuk është e domosdoshme tani. Ajo pyeti Naim Malokun : “Nëse je p.sh. kryeministër, a lejon të emërohet një person që komprometon Qeverinë?”.

Naim Maloku tha se ka prituri që në këtë takim do të ftohen nga kryetari dy kandidatët e rekomanduar dhe të diskutohet më detalisht, përndryshe kjo është dëshpëruese kur dihet se drejtori aktual i ZRRUM është potencuar pozitivisht nga Kuvendi sa i përket funksionimit të zyrës në fjalë. Ai konsideron se kemi të bëjmë me diktate partiake me çka edhe vendimi i Qeverisë mund të konsiderohet si emërim partiak, sepse vërejtje nuk ka pasur në ish drejtorin, i vetmi gabim i të cilit është se nuk është anëtarë i ndonjë partie, ndaj propozoi që procedimi të bëhet në Kuvend dhe atje të vendoset për kandidatët.

Berat Luzha konsideroi se nuk kemi të bëjmë me ndërrim të personit, ngase ish drejtorit i mbaron mandati pa marr parasysh për sukses apo jo në punë. Kjo detyrë është lidhur me mandat, ndaj Qeveria nuk ka kurrfar obligimi ndaj tij, përveç nëse ka konkurrua apo është lajmërua disi sërish për atë pozitë.

Selvie Halimi shtoi se komisioni nuk ka njohuri detale se cili kandidat në cilën parti është, ndaj prapë sugjeroi këta dy kandidatë me mundësi që tjera herë të mund të ftohen kandidatët për diskutim-vlerësim dhe të hartohet akti konkret ligjorë për këto emërim.

Naim Maloku tha se një Qeveri që dëshiron prosperitet i emëron të suksesshmit, mirëpo edhe nëse emëron duhet të zbatoj një rrugë ligjore (konkurs etj) e cila do ti garantonte atyre që korrin sukses prapë të konkurrojnë, ndaj për shkak se kjo rrugë nuk është bindëse atëherë si mundemi të rekomandojmë Kuvendit “votoni sepse kandidatët janë të mirë”. Nëse dikush zgjidhet pa konkurs, atëherë ka mjaft dyshime. Këtu si kriter të vetëm shohim diplomën, gjë të cilin gjithkush që konkurron e ka, përfundoi ai.

Berat Luzha përsëriti se këtu duhet të vërtetohet a është vepruar sipas ligjit, çka do të ishte udhës të vërtetoi eksperti ligjor i cili mund të caktohet nga kryesia për secilin rast të dyshimtë, ndaj interpretimi nga zyra ligjore e Kuvendit është e domosdoshme në këtë rast, konkretisht vendimi i Qeverisë nr.05/63 dt.7.6.2009 a është e bazuar në ligj apo jo, citimi: “nëse po atëherë duhet ta tërhiqni fjalën” (drejtuar Naim Malokut).

Naim Maloku tha se ai nuk tërheq fjalën ngase nuk fyeu askënd dhe se po këto fjalë do ti thotë edhe para seancës plenare dhe TV, ndaj përsëriti sugjerimin e tij për këtë pikë : komisioni e procedon këtë çështje në Kuvend por pa rekomandim për miratim apo jo.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Kërkohet interpretimi i Zyrës Ligjore të Kuvendit të Kosovës rreth përzgjedhjes nga Qeveria të kandidatëve për Drejtor dhe zv. Drejtor në Zyrën e rregullatorit për ujëra e mbeturina, respektivisht a është e bazuar në ligj vendimi i Qeverisë nr. 05/63 dt. 7.5.2009.

2. Procesverbali shërben si arsyetim i përfundimit të komisionit, ndërsa përgjigja duhet ti drejtohet komisionit deri në mbledhjen e radhës më 16.6.2009.

3. Të ndryshme

Berat Luzha ngriti çështjen e mospranisë së kryetarit të Komisionit Lulzim Zenelit në vizitat e terrenit për monitorim të Ligjit për Mbeturina dhe në disa mbledhje të komisionit , si dhe në mbledhjen e sotme, ndaj konstatoi se nuk është korrekte qasja e kryetarit të komisionit në punën e komisionit, gjithashtu edhe për çështjen e shumës 10.000 euro a i takojnë komisionit ky fond apo jo. Komisioni nxori :

K O N K L U D I M

I DËRGOHET procesverbali nga mbledhja e sotme Kryetarit të Kuvendit z. Jakup Krasniqit dhe Kryetarit të Komisionit z. Lulzim Zenelit duke cituar fjalët e deputetit Berat Luzha :” nuk është korrekte qasja e kryetarit të komisionit në punën e këtij komisioni”.

2. KËRKOHET nga Kryetari i Komisionit të hulumtoi për fondin 10.000 euro a janë shfrytëzuese për komisionin, nëse po, atëherë në mbledhjen e radhës të debatohet për planin e shfrytëzimit të tyre nga Komisioni.

Mbledhja e radhës u caktua për 16.6.2009 në orën 13,00 me pikat e propozuara, kjo mbledhje përfundoi në orën 14,05.

Kryesuesi i Komisionit,
Naim Maloku